GJUHA SHQIPE

LIBËR LEXIMI

ATDHE HYKOLLI



1

KLASA

LIBRI I MËSUESIT / ES

Për klasën e parë të arsimit fillor

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

Shtëpia Botuese “Dukagjini”
Hajdar Dushi, nr. 27
Prishtinë, 10 000
Republika e Kosovës

www.dukagjinibotime.com
info@dukagjinipublishing.com

© Shtëpia botuese "Dukagjini”, 2019

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, memorizohet apo të përcillet në ndonjë formë a me ndonjë mjet elektronik, mekanik, me anë të fotokopjes, në disk ose në mënyra të tjera, përfshirë dhe kinemanë, radion, televizionin, pa autorizimin me shkrim nga botuesi.

Botimi i parë, viti 2019.

Shtypi: SH.P.K **"DUKAGJINI"** Pejë

Atdhe Hykolli
Gjuha Shqipe 1 - Libri i mësuesit/es për klasën e parë

Për botuesin: Agim Lluka
Redaktore ekzekutive: Erza Mati
Redaktor teknik: Lavdim Beqiri
Recensentë: Dr. Fadil Latifi, Prof. Ardita Berisha, Mësuese Diana Duraku, Psikolog Shkëlqim Statovci
Kopertina: Arvan Berisha

Të gjitha fotografitë dhe ilustrimet © Shtëpia Botuese “Dukagjini”.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës e ka lejuar
për botim dhe përdorim këtë libër të mësuesit/es për klasën e parë të arsimit
fillor, me vendimin numër 302/01-b, të datës 12.07.2019

PËRMBAJTJA

Kurrikula lëndore/programi mësimor 5

Njësia mësimore 1 - Luajmë 9

Njësia mësimore 2 - Zana dhe fqinjtë 11

Njësia mësimore 3 - Maçoku dhe zogjtë 13

Njësia mësimore 4 - Fotografitë e Blertës 17

Njësia mësimore 5 - Ardhja e Piter Panit 19

Njësia mësimore 6 - Ngjyrat 21

Njësia mësimore 7 - Loja me rima 23

Njësia mësimore 8 - Dinozaurët 25

Njësia mësimore 9 - Vëllai i vogël i Artës 27

Njësia mësimore 10 - Për të qeshur 29

Njësia mësimore 11 - Profesionet 33

Njësia mësimore 12 - Shkronjat 35

Njësia mësimore 13 - Ditëlindja e Artës 37

Njësia mësimore 14 - Bashkimi bën fuqinë 39

Njësia mësimore 15 - Gjëegjëzat 41

Njësia mësimore 16 - Shoku i Lulit 43

Njësia mësimore 17 - Gjallesat e mëdha 45

Hyrje

Të nderuar mësues/e

Mësimi i gjuhës dhe i shkathtësive komunikuese është objektiv themelor në arsimin e detyruar në gjuhën shqipe në Kosovë.

Libri i leximit, si pasabetare, synon t'i përforcojë aftësitë e leximit të nxënësve dhe të krijimit të shprehive bazike të shkrimit dhe të leximit.

Në përfundim të klasës së parë, pra, pasi të ketë mësuar nga Libri i leximit i klasës së parë dhe pas nxënies së shkronjave dhe të shkrim-leximit nga Abetarja, është e pritshme që nxënësi/nxënësja të lexojë në mënyrë të rrjedhshme, të kuptimshme, me intonacion të duhur dhe të mund të krijojë shkathtësi bazike për të diskutuar vizatime, tekste, objekte të ndryshme. Po ashtu, ai/ajo do të njihet me kategori të ndryshme tekstore dhe do të mësojë të diskutojë rreth teksteve të tilla, të ndryshme. Ai/ajo do të mësojë, njëherësh, shkathtësi bazike të të hartuarit, për të shprehur mendime të thjeshta, për të përshkruar sende, vizatime, pamje e për të rrëfyer situata të thjeshta.

Mirëpo, mësimi i leximit është proces zhvillimor dhe afatgjatë. Klasa e parë është një hap i një procesi që përmbyllet, kur nxënësi/nxënësja të jetë në moshë madhore dhe të mund të zbarthejë materiale leximore të shkallëve të larta të vështirësisë dhe të abstraksionit.

Mësimi i leximit ka raportin lexues/e –tekst – detyrë krahas kontekstit të përgjithshëm kulturor e shoqëror të lexuesit/lexueses. Ambienti mësimor në Kosovë përfshin klasë të përziera, ku përfshihen fëmijë të niveleve të ndryshme të aftësisë së nxënies dhe të shtesave të ndryshme shoqërore e kulturore: interesa të ndryshëm, aftësi arsyetimi të ndryshme, shkallë të ndryshme motivimi dhe, përfundimisht, përvoja të ndryshme.

Synohet që përmes leximit (me zë) të nxitet edhe shkathtësia e dëgjimit të tekstit për ta afruar gjuhën më komplekse dhe fjalësin e ri. Pastaj, diskutimet, detyrat dhe pyetjet e ndryshme synojnë krijimin e shkathtësive për zbërthime të koncepteve abstrakte dhe lidhjeve tekstore me përvojat vetanake.

Gjinia (zhanri) tekstor dhe disenji i tekstit janë krijuar me synimin që të krijohet një komunikim më i plotë, përfshirë ilustrimet pamore. Mësuesit/mësueset pritet që, sipas nevojës, të shtojnë a heqin detyra, të japin sqarime të nevojshme, të ofrojnë zgjidhje shtesë dhe të përzgjedhin mënyra të të lexuarit (të përbashkëta, individuale, në çift).

Lesuesi-lexuesja dhe teksti shkojnë në raport me detyrën e kërkuar. Disa detyra janë më të thjeshta e disa më të vështira. Mësues/mësuesja duhet të përcaktojë shkallën e thellësisë së tekstit, ta zbërthejë synimin didaktik të atij teksti si dhe të dallojë kur teksti synon të ofrojë informacion, argëtim, apo udhëzim (p.sh. kur ofrohen njësitë mësimore).

Konteskti i mësimit, ndërkaq, lidhet me elemente të tilla si shkalla shoqërore, aftësia intelektuale dhe ambienti fizik. Gjatë gjithë kësaj kohe, është shumë me rëndësi që mësimi të mos jetë shumë i ngurtë. Një pjesë shumë e madhe e librit të leximit është krijuar në mënyrë që të mësohet përmes lojës dhe të mësohet që të ketë rëndësi mendimi i nxënësit/nxënëses. Më me

rëndësi se informacioni i thjeshtë dhe se shkathtësia bazike, është që nxënësi të mos e humbë aftësinë kreative. Shumë shpesh, ndjekja e rregullave dhe vendosja e kornizave të ndryshme krijojnë kufizime të të menduarit te nxënësit/nxënëset dhe, me këtë, edhe shuarje të impulseve kreative. Në shumë raste, bashkëpunimi, ndarja e mendimeve dhe diskutimi, pas leximit, ofron bazë shtesë për të kuptuarit e tekstit të lexuar.

Libri i leximit, së këndejmi, përbëhet nga njësi të ndryshme që inkorporojnë më vete më shumë tema dhe gërshetojnë rezultate të pritshme që mund të përforcohen nga njësia në njësi. Prandaj, nuk kemi të bëjmë me njësi të ngurta, në të cilat njëra shpreh një temë të vetme dhe një grup rezultatesh të pritshme të nxënësit, por gërshetohen si temat, ashtu edhe rezultatet e pritshme.

Organizimi strukturor është i tillë që përfshin parapërgatitje për tekstin ose tekstet, pastaj është pjesa e leximit të teksteve dhe, pastaj është pjesa pas leximit që është edhe më thelbësorja.

Leximi i tekstit ka të bëjë kryesisht me zhvillimin e aftësive të leximit, të shpejtësisë së leximit, të intonacionit – sidomos mbështetur në shenjat e pikësimit, ndërsa pjesa pas leximit aftëson nxënësin/nxënësen për ta nxënë përmbajtjen e tekstit dhe për të diskutuar nocione të tjera të parapara në planin dhe programin mësimor.

Mësuesit/mësueset do të jenë të lirë të zgjedhin forma, metoda dhe teknika të mësimdhënies sipas zgjedhjes së tyre krahas teksteve dhe detyrave brenda tekstit. Zgjedhjet përcaktohen nga numri i nxënësve/nxënëseve brenda klasës.

Teksti është hartuar sipas mësimit të ashtuquajtur tradicional që i përgatit nxënësit/nxënëset për testimin e standardizuar, me të cilin do të përballen në nivelet e mëtutjeshme të shkollimit. Kjo përfshin detyra, pyetje, kuize të ndryshme, përmes të cilave nxënësi/nxënësja përgatitet për mësimet e mëvonshme. Po ashtu, teksti është mbështetur në mësimin ndijor/shqisor që përfshin mësimin vizual (përmes pamjes), auditor (përmes dëgjimit), kinestetik (përmes aktivitetit fizik) dhe digjitale. Mësuesi/mësuesja u oforn nxënësve/nxënëseve përvoja shtesë, aktivitete, materiale vizuele dhe audio-digjitale dhe bashkëpunim mes vetë nxënësve/nxënëseve.

Si forma propozohen ajo individuale, kur ka numër më të vogël nxënësish në klasë, në çifte dhe ajo në grupe, kur ka numër më të madh nxënësish/nxënësesh. Propozohen metoda e punës me tekst, pastaj ajo e demonstrimit dhe ajo e bashkëbisedimit si më kryesoret sipas njësive. Si teknika mësimdhënieje, po ashtu, propozohen disa, përfshirë metodën e drurit (pemës së quajnë në Shqipëri) të mendimeve (ndryshe edhe klaster), brainstormingu (stuhi mendimesh), xhigsou, diskutimi, Inserti e kështu me radhë.

Teksti përfshin edhe njësi që lidhen me mësimin e tingujve, të gramatikës dhe të kategorive tekstore, si elemente mbështetëse për shkathtësinë e leximit dhe shkathtësitë e komunikimit.

Fusha kurrikulare:	***Lënda*:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

KURRIKULA LËNDORE/PROGRAMI MËSIMOR

Konceptet
Tekstet letrare dhe jo letrare

Temat
Poezia Përallëza Përralla Tregimi Gjëegjëza Fjalët e urta Mesazhe Urimi Letra të thjeshta Porosi Shënime personale

Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
- Dallon elemente themelore të poezisë nga proza; - Dallon formën e përrallëzës, përrallës, tregimit, gjëegjëzës, fjalëve të urta, urimeve, shënimeve personale, mesazheve etj.; - Shpreh përjetime emocionale, personale, gëzime, shqetësime dhe dëshira për situata të caktuara; - Flet në mënyrë të pavarur për një tekst të shkurtër letrar ose joletrar; - Flet për ngjarjen kryesore në tekst; - Shkruan fjali dhe tekste (fjali) shumë të shkurtëra për jetën dhe dëshirat e tij; - Dallon pjesët e shkruara nga pjesët e ilustruara; - Përshkruan rrezikun nga dukuritë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu; - Flet për të afërmit që i ka jashtë vendit.

Konceptet
Gjuha figurative dhe jofigurative

Temat
Sinonimet Antonimet Hiperbola Krahasimi Personifikimi

Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
- Dallon kuptimin elementar të sinonimeve dhe antonimeve; - Identifikon pjesët (shprehjet) tepër të zmadhuara të qenieve, sendeve a tipareve të tyre; - Dallon figurën e krahasimit; - Kupton figurën e personifikimit te përrallëza.

Konceptet
Kritika, teoria, historia

Temat
Elemente të përgjithshme kulturore te tema të përgjithshme kulturore te tema të ndryshme

Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
- Kupton elemente të ndryshme kulturore; - Përdor drejt fjalët zonjushë, zonjë, zotëri, si dhe përemrat Ti, Ju kur iu drejtohet të rriturve; - Luan role sipas modeleve; - Shfaq kujdes për ambientin që e rrethon.

Konceptet
Sistemi gjuhësor

Temat
Tingujt Shkronjat Rrokjet Fjala Fjalia Shenjat e Pikësimit Intonacioni Foljet ndihmëse kam dhe jam Emri, mbiemri Përemri

Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
- Dëgjon, identifikon dhe shqipton drejt tingujt, zanor dhe bashkëtingëllorë; - Dallon rrokjen në fjalë; - Shkruan drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla; - Përdor drejt shkronjat e mëdha në fillim dhe përgjatë fjalisë; - Përdor drejt shenjat e pikësimit: pikën, presjen, pikëpyetjen, pikëçuditjen etj.; - Shkruan drejt fjalët, fjalitë dhe i shqipton me intonacionin e duhur; - Kupton dhe dallon foljet ndihmëse kam dhe jam në kohën e tashme, në kohën e kryer dhe në kohën e ardhme; - Kupton, dallon dhe përdor drejtë emrin, mbiemrin dhe përemrin; - Shkruan fjalë apo fjali për përmbajtjen e figurës apo vizatimit; - Shkruan fjalë duke parë figura; - Shkruan fjali në mënyrë të pavarur dhe përdor drejt shkronjat; - Identifikon mjetet audio-vizuale dhe ato të teknologjisë informative dhe i përdor ato për të dëgjuar, për të komunikuar dhe për të bërë regjistrime; - Bën vizatime të thjeshta mbi bazë imagjinare dhe shkruan fjali për përmbajtjen e figurës që ka vizatuar; - Përdor lojën për të mësuar; - Lexon tekste të ndryshme qartë, pa gabime dhe në mënyrë shprehëse.

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Shkronjat Njësia mësimore 1 **Luajmë**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Shqipton drejt tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë;

Shkruan sipas përmbajtjes së vizatimit;

Vizaton figura sipas fjalisë së dhënë

Kriteret e suksesit:

Shkruaj saktë së paku tri fjalë

Vizato figura sipas fjalisë së dhënë

Fjalët kyçe: lepuri, televizori, automobili

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Matematikë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë

ORGANIZIMI I MËSIMIT

PJESA HYRËSE:

Njësia nuk ka tekst dhe pyetje lidhur me tekstin. Nxënësit/nxënëset e kanë përfunduar Abetaren dhe i kanë mësuar tashmë shkronjat.

Hapi 1

Një fjalëkryq, në të cilin mbështetur në figurat e ofruara, nxënësit/nxënëset do t'i shkruajnë përgjigjet (shkronjat).

PJESA KRYESORE

Hapi 2

Loja me pika. Në pikat e caktuara, nxënësit/nxënëset do t'i shënojnë shkronjat e duhura, për t'i nxjerrë fjalët e kërkuara sipas vizatimeve. Njohuritë e tyre të mëparme dhe varietetet leksikore varësisht nga shtresimet e ndryshme rajonale e kulturore mund të krijojnë mundësi që ndonjë nxënës të mos shënojë drejt fjalën e kërkuar (p.sh.: mund të shënojë stadioni, në vend të stadiumi). Detyrë e mësuesit/mësueses është që, pa "qortuar" për përgjigjet e gabuara, t'i orientojë te përgjigjet e sakta dhe t'i shpjegojë dallimet.

PJESA PËRFUNDIMTARE

Hapi 6

Detyra e formimit të fjalive sipas vizatimeve. Nuk ka nevojë për ndërhyrje të përgjigjeve alternative të nxënësve - p.sh.: Vajza shkon në shkollë është përgjigjja e pritshme, por do të.

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Elemente të ndryshme kulturore te tema të ndryshme Njësia mësimore 2 **Zana dhe fqinjtë**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion
Përdor drejt fjalët zonjushë, zonjë, zotëri
Plotëson fjalitë me mbiemrat Ti dhe Ju sipas kërkesave të detyrave

Kriteret e suksesit:

Lexo saktë dhe me intonacion

Shkruaj përemrat Ti dhe Ju në fjali

Fjalët kyçe: zonjë, zonjushë, zotëri ,Ju , Ti

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë

ORGANIZIMI I MËSIMIT

PJESA HYRËSE:

Një pjesë hyrëse që ka të bëjë me lojën me sjelljen komunikuese ndaj personave të tjerë (mund të jetë edhe në formën e ndonjë rrëfimi të shkurtër)

- **Hapi 1**
- Nxënësit e lexojnë tekstin dhe e diskutojnë atë. Në klasë me më shumë nxënës/nxënëse mund të bëhet leximi me metodën e ndërthurrjes (jigsaw), që është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, me ç'rast leximi i njësisë nuk bëhet nga të gjithë nxënësit/nxënëset, por disa caktohen për të lexuar pjesë përkatëse dhe pastaj ndërthurren elementet, duke mësuar nga njëri-tjetri.

  Nxënësit e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara.
- Mund të zbatohet teknika Insert, një sistem ndërveprues i orientuar nga mësuesi/mësuesja që i mban nxënësit aktiv dhe me qëndrim kritik ndaj tekstit të lexuar, duke parë çfarë kanë ditur, çfarë nuk kanë ditur, çfarë kanë menduar më ndryshe dhe çfarë nuk kanë kuptuar. Nxënësit mësojnë që krahas leximit të qartë, të marrin parasysh edhe përmbajtjen e asaj që mësojnë – të kuptojnë atë që janë duke e lexuar.

PJESA KRYESORE

- **Hapi 2**
- Lexohet njësia që tregon për rregullat e mirësjelljes lidhur me përdorimin e fjalëve: zonjë, zonjushë, zotëri si dhe përemrave Ju dhe Ti. Mësuesi/mësuesja orienton dhe konkretizon me shpjegime shtesë.

  (Si këshillë shtesë është që mësuesit/mësueset të bëjnë vetë dallimin ndërmjet zotëri pa emrin e individit dhe zoti Filan, pra me emrin e individit – nuk përdoret forma zotëri Filan).

PJESA PËRFUNDIMTARE

- **Hapi 3**
- Diskutim dhe detyra.
- Diskutohet, përmes pyetjeve të shtruara.
- Ofrohet në tekst një detyrë, në të cilën, rrumbullakësohet mësimi për sjelljen, ashtu që nxënësit mbushin hapësirat boshe, sipas njohurive të arritura deri tash. Mësuesi/mësuesja orienton pavërejtshëm nga përgjigjet e sakta.
- **Hapi i katërt:**
- Secila njësi që këtej e ka pjesën ABC, në të cilën mësohet për kuptimin e figurshëm të fjalëve e të shprehjeve. (Përgjigjja e saktë nën c).

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Përrallëza; Personifikimi; Letra të thjeshta; Intonacioni (me ndihmën e mësuesit/mësueses); Emri Njësia mësimore 3 **Maçoku dhe zogjtë**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacoin
Tregon përmbajtjen e tekstit të lexuar me fjali të thjeshta
Krahason përrallëzën me tregimin e lexuar

Kriteret e suksesit:

Lexo saktë dhe me intonacion

Trego dallimet mes përrallëzës e tregimit

Plotëso detyrat sipas kërkesave

Fjalët kyçe: përrallë, tregim, kafshë

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, fotografi me kafshë

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia e tretë përbëhet nga një tekst kryesor dhe dy nënnjësi, njëra nga të cilat përfshin një pjesë mësimi. Të gjitha këto pasohen nga pyetje dhe detyra të ndryshme.

Hyrja

Mësuesi/mësuesja hap diskutim për përrallat dhe përrallëzat. Tregojnë dallimin mes një përrallëze (të shkurtër) dhe një përralle (më të gjatë). I njofton nxënësit/nxënëset se ajo që do të lexojnë është një përrallëz.

Hapi 1

Nxënësit e lexojnë tekstin. Në klasë, me më shumë nxënës/nxënëse mund të bëhet leximi me metodën e ndërthurrjes. Nxënësit e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara. Mund të ofrohet teknika e drurit të mendimit. Nxënësit mësojnë që krahas leximit të qartë, të marrin parasysh edhe përmbajtjen e asaj që mësojnë – të kuptojnë atë që janë duke e lexuar.

Hapi 2

Krijohet një diskutim për personifikimin, ashtu që, nxënësi/nxënësja të kuptojë se personazhet e përrallave janë të lidhura me veçoritë e njeriut. Mund të zbatohet stuhia e mendimit (brainstorming).

Hapi 3

(Shërben edhe si hyrje njësie)

Krijohet një diskutim për tingujt që i lëshojnë disa kafshë. Bëhet kujdes që të mos ketë situata të talljes, por të argëtimit.

Mund të kërkohet të imitohen kafshë, për të cilat nuk ka ndonjë konsensus onomatopeje – p.sh.: si bën dhelpra?

Hapi 4

Nxënësit e lexojnë tekstin. Në klasë me më shumë nxënës/nxënëse mund të bëhet leximi me metodën e ndërthurrjes. (Tregohet se teksti është në formë të një busulle, si prosi, si letër e shkruar). Nxënësit e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara.

Hapi 5
Bëhet diskutim për ushqimin e preferuar të ujkut dhe të nxënësve/nxënëseve. Mund të zbatohet teknika e rrjetit të diskutimit.

Hapi 6
Shpjegohen fjalët e reja. Disa prej tyre nuk janë krejt të panjohura për nxënësit, por janë përzgjedhur për diskutim, në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës në diskutim, e jo vetëm marrës të informacionit.

Hapi 7
Lexohet njësia që tregon për emrat. Mësuesi/mësuesja orienton dhe konkretizon me shpjegime shtesë.

Hapi 8
Nxënësit/nxënëset marrin detyrë për shtëpi.

Hapi 9
Shërben si pjesë hyrëse e një ore të re. Mësuesi/mësuesja diskuton me nxënësit për përrallën e Kësulëkuqes dhe pastaj ua tregon një variant të saj.

Hapi 10
Hapet diskutimi për përrallën sipas pyetjeve të shtruara. Mësuesi/mësuesja e orientojnë bisedën drejt elementeve të personifikimit, në mënyrë që nxënësi/nxënësja ta përsëris idenë.

Hapi 11
Nxënësit e lexojnë tekstin, e diskutojnë dhe e interpretojnë sipas pyetjeve të shkruara.

Hapi 12
Diskutohen fjalët e reja.

Hapi 13
Nxënësit/nxënëset i plotësojnë detyrat. Mësuesi/mësuesja edhe një herë iu flet për dallimet mes përrallës dhe teksteve që nuk janë përrallë, si dhe mes përrallës dhe përrallëzës.

Hapi 14
Pjesa ABC - (Përgjigjja e saktë nën c)

Shënime:

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Shënime personale; Shkronjat Njësia mësimore 4 **Fotografitë e Blertës**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion
Shkruan fjali të shkurtëra për jetën dhe dëshirën e tij/saj
Krahason fotografitë me tekstin

Kriteret e suksesit:

Shkruaj së paku dy fjali të shkurtëra

Trego dallimet mes fotografisë dhe tekstit

Fjalët kyçe: Fotografi, tekst

Burimet: Libri, fletorja, lapsi,

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një tekst leximi me ilustrime, një njësi mësimore dhe pyetjet e detyrat.

Hyrja

Mësuesi/mësuesja flet shkurtimisht për konceptin e familjes dhe të fotografive familjare (1-2 min.)

Hapi 1

Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin. Diskutohet dhe interpretohet teksti sipas pyetjeve të shtruara.

Hapi 2

Nxënësit/nxënëset flasin për familjen e tyre dhe për anëtarët e familjes që jetojnë jashtë Kosovës.

Hapi 3

Nxënësit/nxënëset marrin detyrë të shkruajnë për fotografitë e tyre dhe për anëtarët e familjes që i kanë jashtë Kosovës.

Hapi 4

Si hyrje e orës, lexohen detyrat e një ore më parë.

Hapi 5

Lexohet njësia e mësimit. Mësuesi/mësuesja orienton dhe jep shpjegime shtesë. Përdorimi i shkronjës së madhe përfshihet në Drejtshkrimin e Gjuhës Shqipe, por nxënësve/nxënëseve iu ofrohen dhe iu kërkohet dije vetëm për aq sa është në njësinë mësimore. Ata vetëm do të mësohen me idenë e përdorimit të shkronjës së madhe te emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë. Mund të zbatohet druri i mendimit.

Hapi 6

Nxënësit/nxënëset plotësojnë detyrën e kërkuar. Mësuesi orienton përgjigjet e sakta.

Hapi 7

Hapet diskutim për përsëritjen e përdorimit të shkronjës së madhe. Mund të përdoren klasteri (pema e mendimeve) dhe rrjeti i mendimit.

Hapi 8

Pjesa ABC - (Përgjigjja e saktë nën a)

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Tregimi, përralla Njësia mësimore 5 **Ardhja e Piter Panit**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion
Përshkruan personazhet e tekstit të lexuar
Analizon ngjarjet e lexuara

Kriteret e suksesit:

Shkruaj së paku tri personazhe të filmave të vizatuar

Trego me fjalë të thjeshta përmbajtjen e teksit të lexuar

Fjalët kyçe: Piter Pan, personazh, film i vizatuar, zonjë, zonjushë

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një tekst leximi, nga një tekst joletrar lidhur me personazhet e tregimit me "Piter Panin" dhe pyetjet e detyrat që lidhen me këto tekste.

Hyrja
Mësuesi/mësuesja hap diskutim për përrallat, filmat e vizatuar, heronjtë e ndryshëm imagjinar.

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin. Diskutohet dhe interpretohet teksti sipas pyetjeve të shtruara.

Hapi 2
Diskutohen fjalët e reja, sipas ilustrimeve në libër. Mësuesi/mësuesja mund të konsultojë Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, por shpjegimet për nxënës/nxënëse ofrohen në mënyrë të thjeshtuar.

Hapi 3
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin për personazhet. Në klasë, me më shumë nxënës/nxënëse mund të bëhet leximi me metodën e ndërthurrjes dhe/ose stuhi mendimesh.

Ngjyrosen personazhet.

Hapi 4
(Pjesa bashkëbisedojmë dhe shëno personazhet e filmave të vizatuar që të pëlqejnë më shumë):

Mësuesi/mësuesja hap diskutim për personazhet e filmave të vizatuar, sipas pyetjeve. Nxitet diskutimi i nxënësve për personazhe. Matet dëshira e tyre për të lexuar përralla dhe për të parë filma të vizatuar. Nxitet procesi i të menduarit për mesazhet që përçojnë ata filma.

Hapi 5
Diskutohet në formë të përsëritjes, tema e sjelljes: zonjë – zonjushë, përmes tekstit të diskutuar për Piter Panin.

Hapi 6
Pjesa ABC – Përgjigjja e saktë nën a.

* Si formë alternative, disa nga hapat mund të lihen detyrë shtëpie

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Shënime personale, Mbiemri Njësia mësimore 6 **Ngjyrat**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion
Përshkruan figurat e dhëna me mbiemra
Shkruan fjalë për të treguar ngjyrat

Kriteret e suksesit:

Shkruaj së paku tre mbiemra për të përshkruar figurat e dhëna

Fjalët kyçe: mbiemër, ngjyrë

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Kjo njësi përbëhet nga një tekst leximi me ilustrime, një tekst mësimi si dhe pyetjet e detyrat rreth atij teksti.

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin. Diskutohet dhe interpretohet teksti sipas pyeteve të shtruara.

Hapi 2
Diskutohet për lojëra të ndryshme që mund të luajnë nxënësit/nxënëset. Mund të përdoret metoda e stuhisë së mendimit (brainstorming).

Hapi 3
Përfshin detyrën për vizatimin e lodrës, për bashkimin e pikave, duke përshkruar se çfarë ka në vizatimin e pikave. Inkurajohen imagjinata e fantazia.

Hapi 4
Mund të shërbejë si hyrje në orën e dytë, të së njëjtës njësi. Ngjyrosja e fustanit dhe e topit sipas imagjinatës, për të parë se do të shfrytëzohen ngjyra të ndryshme. Kjo krijon mundësi të diskutimit të emrave të ngjyrave.

Hapi 5
Në vazhdën e detyrës paraprake, nxënësit i shënojnë dhe i lexojnë emrat e ngjyrave që i njohin.

Hapi 6
Ngjyrosje, jo më në bazë imagjinare, po në bazë të ngjyrave të kërkuara.

Hapi 7
Lexohet njësia mësimore. Mësuesi/mësuesja orienton dhe jep shpjegime shtesë. Vizaton drurin e mendimit në tabelë.

Hapi 8
Nxënësi/nxënësja përsërit ngjyrat dhe mbiemrat, sipas modelit të vizatuar.

* Në rast se tërë njësia do të përmblidhet në një orë, atëherë një pjesë e hapave, lihen si detyrë shtëpie.

Hapi 9
Pjesa ABC (përgjigjja e saktë nën b)

Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa:
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Poezia, Elemente kulturore te tema të ndryshme Njësia mësimore 7 **Loja me rima**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion
Luan lojën e "Rimave"
Krahason poezinë me prozën
Shkruan fjalë që tregojnë rimë

Kriteret e suksesit:

Shkruaj së paku tre fjalë që kanë rimë mes vete

Luaj lojën e "Rimave"

Fjalët kyçe: rimë, poezi,

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një tekst kryesor në prozë dhe një vjershë, të ndjekura nga pyetje dhe detyra.

Hapi 1:
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin. Nxënësit/nxënëset e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara a,b, c.

Hapi 2
Nxënësit e mësojnë rimën si ide, duke lidhur mes vete fjalët që rimohen. Mësuesi/mësuesja i orienton nga përgjigjet e sakta.

Nxënësit/nxënëset me iniciativën e mësuesit e luajnë mes vete, qoftë në grupe, qoftë në çifte lojën e rimave.

Hapi 3
Si hyrje për nën-njësinë e re, përsëritet shkurtimisht loja e rimave dhe ndonjë nga vjershat e mësuara më herët në Abetare.

Hapi 4
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin më vete dhe vendosin fjalët e duhura në hapësirat e lëna qëllimisht bosh nga autori. Inkurajohen përgjigje alternative (këndojnë, cicërojnë; bukurinë, hijeshinë, madhështinë). Nxënësit/nxënëset e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara. Mund të përdoren teknika të ndryshme.

Hapi 5
Diskutohen fjalët e reja. Mësuesi/mësuesja mund të konsultohet me Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, por shpjegimet i jep të thjeshtuara.

Hapi 6
Lexohet teksti i bashkëbisedimit dhe diskutohet. Përdoret metoda e stuhisë së mendimit (brainstorming).

Hapi 7
Nxënësit do të shkruajnë fjali të thjeshta për ruajtjen e natyrës. (Mund të jetë si detyrë shtëpie).

Hapi 8
Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën b.

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Stripi, emri dhe mbiemri Njësia mësimore 8 **Dinozaurët**	RNSH: I.1,4,5 ; II.6,7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion
Analizon personazhet e tekstit
Shkruan rreziqet që mund të shkaktojnë katastrofa natyrore

Kriteret e suksesit:

Përmend së paku tri fjalë që tregojnë katastrofa natyrore

Fjalët kyçe: strip, kuriozitet, dinozaur, katastrofë natyrore

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një strip, një tekst me shënime (fakte) për dinozaurët, një njësi mësimore dhe pyetje e detyra.

Hyrje
Mësuesi/mësuesja tregon se çka është stripi (1-2 min.)

Hapi 1 - Nxënësit e lexojnë stripin më vete. Mësuesi/mësuesja mund të zgjedhë që teksti të luhet si skeç. Nxënësit/nxënëset e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara. Mund të përdoren ndërthurrja dhe inserti.

Hapi 2 - Nxënsit/nxënëset marrin detyrë të përshkruajnë atë që shohin në fotografinë e parë. Nxiten imagjinata dhe fantazia krijuese.

Hapi 3 - Nxënësi/nxënësja merr detyrë të përshkruajë drekën në shtëpinë e tij.

Hapi 4:
Nxënësi/nxënësja argëtohet, duke bashkuar pikat për të parë një dinozaur.
Mësuesi/mësuesja mund të zgjedhë që ndonjëra nga hapat: 2, 3, 4, të jenë detyrë shtëpie.

Hapi 5
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin. Në klasë me më shumë nxënës/nxënëse mund të bëhet leximi me teknikën e ndërthurrjes.

Hapi 6
Nxënësit/nxënëset e ngjyrosin sipas imagjinatës dinozaurin e vizatuar. Mësuesi/mësuesja shfrytëzon rastin për të përsëritur ngjyrat dhe mbiemrat.

Hapi 7
(Teksti dhe pjesa e pyetjeve)

Diskutohet për katastrofat natyrore. Mësuesi/mësuesja zgjedh ndonjë nga teknikat e ndryshme: pema e mendimit, brainstorming, praktikë e drejtuar, bashkëbisedim.

Hapi 8
Përsëriten emrat dhe mbiemrat.

Hapi 9
Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën a

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Antonimet Njësia mësimore 9 **Vëllai i vogël i Artës**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacoin
Shkruan fjalë me kuptim të kundërt - antonime
Përgjigjet në pyetjet e dhëna

Kriteret e suksesit:

Shkruaj së paku dy fjalë me kuptim të kundërt - antonime

Fjalët kyçe: antonim

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një tekst dhe pyetje e detyra të orientuara nga mësimi i antonimeve.

Hyrje

Mësuesi/Mësuesja krijon një hyrje, duke diskutuar qoftë për raporte familjare, qoftë për ide të ndryshme që mbështeten në kundërvënie.

Hapi 1

Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin. Nxënësit/nxënëset e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara. Mund të përdoret teknika insert.

Hapi 2

Diskutohen fjalët e reja. Mësuesi/mësuesja mund të konsultojë Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, por shpjegimet i jep të thjeshtuara.

Hapi 3

Nxënësit e kuptojnë idenë e fjalëve që kanë kuptime të kundërta, duke i lidhur me shigjetë shembujt e ofruar dhe e vazhdojnë idenë, duke mbushur hapësirën e zbrazët. Nuk përdoret askund termi antonim.

Hapi 4

Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën c

Shënime:

_____

_____

_____

_____

_____

_____

Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa:
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Barcoleta; Poezia; Intonacioni dhe shenjat e pikësimit; Elemente të përgjithshme kulturore; Sinonimet; Shenjat e pikësimit Njësia mësimore 10 **Për të qeshur**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion
Shkruan shenjat e pikësimit aty ku duhet
Përgjigjet në pyetjet e dhëna

Kriteret e suksesit:

Shkruaj saktë shenjat e pikësimit në fjali

Fjalët kyçe: tekanjoze, llucë, gojëhapur

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga tri barcoleta dhe një vjershë, udhëzimin për lidhjen e këpucëve, njësinë mësimore për shenjat e pikësimit dhe për sinonimet, bashkë me pyetjet dhe detyrat.

Hyrje
Mësuesi/mësuesja i përgatit nxënësit për orën që ka të bëjë me barcoleta dhe të qeshura.

Hapi 1
Lexohen barcoletat. Me rëndësi është që nxënësi/nxënësja të zhvillojnë të kuptuarit e tekstit, duke lexuar. Mëuesi/mësuesja i orienton nga elementet humoristike (ua shpjegon).

Hapi 2
Diskutohet ideja e barcoletës dhe nxitet diskutimi për elementet humoristike brenda tyre.

Hapi 3
Nxënësit/nxënëset tregojnë barcoleta mes vete dhe marrin për detyrë shtëpie të tregojnë dhe të mësojnë barcoleta në shtëpi.

Hapi 4
Hyrje e njësisë për vjershën që do të mësohet është përsëritja e ndonjë barcolete, nga ato që kanë qenë detyrë shtëpie.

Hapi 5
Nxënësit/nxënëset e lexojnë vjershën. Diskutohet dhe interpretohet teksti sipas pyetjeve të shtruara.

Hapi 6
Diskutohet fjalët e reja. Mësuesi/mësuesja mund të konsultojë Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, por shpjegimet i jep të thjeshtuara.

Hapi 7
Mësuesi/mësuesja i pyet nxënësit që dijnë t'i lidhin këpucët dhe i mëson sipas udhëzimit për lidhjen e këpucëve. Mbahet atmosferë argëtimi dhe bashkëpunimi mes nxënësish.

Hapi 8
Mësuesi/mësuesja diskuton edhe një herë për vjershën si hyrje për njësinë e re.

Hapi 9
Mësohet njësia për shenjat e pikësimit. Mësuesi/mësuesja orienton dhe jep shpjegime shtesë.

Hapi 10
Lexohet edhe një herë vjersha, këtë herë duke pasur kujdes te intonacioni, sipas shenjave të pikësimit.

Hapi 11
Lexohet teksti për sinonimet

Hapi 12
Ushtrohen sinonimet përmes detyrës. Nuk përmendet termi sinonim. Ky hap, bashkë me detyrën e leximit me intonacion sipas shenjave të pikësimit të vjershës, mund të jepen si detyrë shtëpie.

Hapi 13
Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën a

Shënime:

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Poezia; Elemente të ndryshme kulturore, Tingujt Njësia mësimore 11 **Profesionet**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion
Shkruan profesionet e njerëzve që e rrethojnë
Dramatizon, dramën e dhënë

Kriteret e suksesit:

Shkruaj profesionet njerëzve të afërm

Luaj rolin e personazheve në dramën e dhënë

Fjalët kyçe: profesion , lojë

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një tekst në prozë, një vjershë, pyetjet dhe detyrat, mes të cilave përfshihet edhe ndonjë lojë fjalësh, për të zgjidhur shkathtësitë nyjëtimore të tingujve.

Hyrje:
Mësuesi/mësuesja e prezenton profesionin e tij (1-2 min.)

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin. Nxënësit/nxënëset e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara. Mund të përdoren teknika e ndërthurrjes, insert, stuhi mendimesh, rrjeti i diskutimit apo të tjera.

Hapi 2
Diskutohen profesionet. Përdoret teknika e stuhisë së mendimeve.
Nxënësi/nxënësja diskuton për profesionet duke i mbushur hapësirat boshe, sipas modelit të dhënë.
(Mund të jepet edhe si detyrë shtëpie)

Hapi 3
Si hyrje e njësisë për vjershën, mund të diskutohet detyra paraprake.

Hapi 4
Lexohet vjersha. Mund të luhet sipas roleve.
(Diskutohet shkurtimisht vetëm një pyetje lidhur me vjershën).

Hapi 5
Dy detyrat e radhës, shërbejnë për argëtim dhe aftësim për shkathtësitë nyjëtimore.

Hapi 6
Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën a.

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Tingujt, shkronjat, rrokja Njësia mësimore 12 **Shkronjat**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Luan lojën me shkronja
Shqipton shkronjat zanore dhe bashkëtingëllore
Shkruan shkronjat zanore dhe bashkëtingëllore

Kriteret e suksesit:

Luaj lojën me shkronja

Shkruaj saktë shkronjat zanore dhe bashkëtingëllore

Fjalët kyçe: tingull, shkronjë, zanore, bashkëtingëllore, rrokje

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një tetëkahore, dy njësi të shkurtëra mësimi dhe detyra e pyetje.

Hyrje:
Mësuesi/mësuesja i njofton nxënësit/nxënëset për tetëkahoren dhe i udhëzon si ta plotësojnë.

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset e plotësojnë tetëkahoren në punë grupore dhe me ndihmën e mësuesin/mësueses.

Hapi 2
Lexohet teksti i mësimit. Mësuesi/mësuesja orienton dhe shpjegon, duke nxitur interaktivitet të nxënësve dhe duke përsëritur pjesë nga Abetarja.

Hapi 3
Dy detyrat e radhës shërbejnë për të nxitur mësimin e njësisë së sapo mësuar.

Hapi 4
Lexohet teksti i mësimit për rrokjen. Mësuesi/mësuesja orienton dhe shpjegon, duke nxitur interaktivitet të nxënësve dhe duke përsëritur pjesë nga Abetarja.

Hapi 5
Dy detyrat e radhës shërbejnë për të forcuar njësinë e sapo mësuar.
Ndonjë nga detyrat e hapit III dhe V mund të jenë edhe detyrë shtëpie.

Hapi 6
ABC – përgjigjja e saktë nën c.

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Tingujt, shkronjat, rrokja Njësia mësimore 13 **Ditëlindja e Artës**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.1,4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion

Shkruan ditët e javës dhe muajt e vitit

Shkruan ftesë për ditëlindje

Kriteret e suksesit:

Shkruaj me fjalë të thjeshta një ftesë për ditëlindje

Fjalët kyçe: ditëlindje, ftesë, ditë jave, muaj viti, urim

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një pjesë hyrëse dhe disa variante teksti të ftesës për ditëlindje. Krahas kësaj janë pyetjet dhe detyrat.

Hyrja:
Realizohet qoftë përmes fjalëve të mësuesit/mësueses, qoftë përmes leximit individual të nxënësve të pjesës hyrjëse.

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset lexojnë variantet e ftesës.

Hapi 2
Sipas detyrave të parashtruara, nxënësit/nxënëset diskutojnë cila nga ftesat u pëlqen më shumë. Mund të përdoret teknika e stuhisë së mendimit.

Hapi 3
Nxënësit ushtrojnë të hartojnë vetë një ftesë dhe një urim për ditëlindje, si dhe një busullë rasti prindërve.
Mund të jetë edhe si detyrë shtëpie

Hapi 4
Nxitet bashkëbisedimi për ditëlindjen.

Hapi 5
Shënohen ditët e javës dhe muajt e vitit nën udhëzimin dhe shpjegimet e mësuesit/mësueses.

Hapi 6
Pjesa Abc – përgjigjja e saktë nën c – si pjesë e njësisë që lidhet me urimet.

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Skeç , fjalë të urta Njësia mësimore 14 **Bashkimi bën fuqinë**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion

Luan rolin personazheve të dhëna në tekst

Analizon kuptimin e fjalëve të urta

Kriteret e suksesit:

Luaj rolin personazheve të dhëna në tekst

Trego kuptimin e fjalëve të urta të dhëna në tekst

Fjalët kyçe: fjalë e urtë, bashkim, fuçi

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, ngjyrat

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një tekst në formë skeçi, pyetjeve dhe detyrave që kanë synim të mësuarit e fjalëve të urta.

Hyrje:
Mësuesi/mësuesja i përgatit nxënësit për konceptin e fjalëve të urta. Iu tregon se funksionojnë si rregulla urtësie.

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin, duke luajtur role sipas modeleve. Nxënësit/nxënëset e diskutojnë dhe e interpretojnë tekstin sipas pyetjeve të shkruara. Mund të përdoret teknika insert.

Hapi 2
Mësuesi iu tregon nxënësve për fjalët e urta.

Hapi 3
Nxënësit e luajnë lojën e pikave, me ç'rast vërejnë se po dalin fjalë të urta.
Diskutohen kuptimet e atyre fjalëve të urta.
Nxënësit/nxënëset shënojnë disa fjalë të urta dhe e diskutojnë atë që kanë mësuar prej tyre.
Pjesë dhe detyra, sipas zgjedhjes së mësuesit, mund të lihen edhe si detyrë shtëpie.

Hapi 4
Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën a – një fjalë e urtë më vete.

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Gjëegjëzat Njësia mësimore 15 **Gjëegjëzat**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4, 5; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,7

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion

Tregon gjëegjëza të thjeshta

Kriteret e suksesit:

Trego së paku një gjëegjëzë

Fjalët kyçe: gjëegjëzë

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, kompjuteri/interneti

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga tri gjëegjëza dhe disa detyra rreth tyre.

Hyrja
Mësuesi/mësuesja përgatit nxënësit për gjëegjëzat, duke shpjeguar konceptin e tyre si lojë fjalësh që fshehin një kuptim të veçantë.

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset i lexojnë gjëegjëzat. Me rëndësi është që nxënësi/nxënësja të zhvillojë të kuptuarit e tekstit, duke lexuar. Mësuesi/mësuesja i orienton nga elementet kuptimore që dalin (ua shpjegon kontekstet).

Hapi 2
Nxënësit/nxënëset vizatojnë dhe provojnë të krijojnë vetë gjëegjëza. Nuk do t'ia dalin tërësisht, por me rëndësi është të provojnë, duke u nxitur kështu imagjinata dhe fantazia krijuese.

Hapi 3
Do të kërkohet të bëjnë detyra të shtëpisë, duke hulumtuar në internet.

Hapi 4
Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën a.

Shënime:

Fusha kurrikulare:	**Lënda:**	**Shkalla e kurrikulës:**	**Klasa:**
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Skeç, Përemri, Foljet kam dhe jam Njësia mësimore 16 **Shoku i Lulit**	RNSH: I.1,4,5 ; II.7; III.2,3 ; IV.4, 5; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,7

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion

Luan rolin e personazheve të dhëna në tekst

Shkruan në fjali foljet kam dhe jam, aty ku duhet

Kriteret e suksesit:

Luaj rolin e personazheve të dhëna në tekst

Fjalët kyçe: robot, gogël, kompjuter, bibliotekë, fabrikë, makinë

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, kompjuteri / interneti

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga një skeç, dy mësime dhe detyrat e pyetjet lidhur me to.

Hyrje:
Mësuesi/mësuesja përgatit nxënësit/nxënëset për mundësitë e të mësuarit nga teknologjia informative, duke kontrolluar detyrat e njësisë së kaluar.

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset e lexojnë tekstin, duke luajtur role sipas modeleve. Pyetjet dhe detyra pasuese shërbejnë për diskutimin e përmbajtjes së tekstit. Teksti është më i vështirë dhe të kuptuarit e tij realizohet me ndihmë nga mësuesi.

Hapi 2
Nxënësit/nxënëset marrin detyrë shtëpie të shfrytëzojnë internetin për nevoja mësimi.

Hapi 3
Hyrje për njësinë e radhës – nxënësit/nxënëset tregojnë përmbajtjen e përrallës.

Hapi 4
Nxënësit/nxënëset, me ndihmën e mësuesit/mësueses e lexojnë dhe e mbajnë mend mësimin, duke luajtur role. Mësuesi/mësuesja orienton dhe shpjegon. Nxënësit/nxënëset me këtë rast duhet ta mësojnë përdorimin e përemrave vetorë, në të tri vetat njëjës dhe shumës, por pa u përdorur terminologjia e gramatikës. Ata e ushtrojnë zbatimin praktik të përdorimit të përemrave vetorë.

Hapi 5
Nxënësit/nxënëset me ndihmën e mësuesit e lexojnë dhe e mbajnë mend mësimin për kohët e foljeve.
Përmes detyrave të dhëna, nxënësit ushtrojnë përdorimin e foljeve kam dhe jam në kohën e tashme, në të ardhmen dhe në të kryerën.

Hapi 6 –
Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën c – mund të shërbejë edhe si hyrje për njësinë e radhës.

Fusha kurrikulare:	Lënda:	Shkalla e kurrikulës:	Klasa:
Gjuhët dhe komunikimi	Gjuhë shqipe	Shkalla I	I

Tema: Krahasimi, hiperbola Njësia mësimore 17 **Gjallesat e mëdha**	RNSH: I.1,4,5 ; II.6, 7; III.2,3 ; IV.4, 5; V.3,5; VI.1,4 RNF: 1.1,2,3 ; 2.1, 3.4,5 ; 3. 1,2,3,4,5,6,7

Rezultatet e të nxënit të lëndës:

Nxënësi/ja

Lexon pa gabime dhe me intonacion

Krahason gjallesat për nga madhësia dhe tiparet tjera

Kriteret e suksesit:

Krahaso gjallesat për nga tiparet e tyre

Fjalët kyçe: planet, trung, metër

Burimet: Libri, fletorja, lapsi, kompjuteri/interneti

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative

ORGANIZIMI I MËSIMIT

Njësia përbëhet nga dy tekste joletrare, dy njësi të shkurtëra mësimi për krahasimin dhe hiperbolën, disa stripa të shkurtër që ilustrojnë krahasimin e hiperbolën dhe detyrat përkatëse.

Hyrja
Mësuesi/mësuesja e nis orën, duke e kujtuar ABC-në e orës së shkuar.

Hapi 1
Nxënësit/nxënëset i lexojnë tekstet. Në klasë me më shumë nxënës/nxënëse mund të bëhet leximi me metodën e ndërthurrjes. Diskutohet teksti, në mënyrë që nxënësit ta krijojnë idenë e përmasës dhetë krahasimit të përmasave të ndryshme e të ngjashme.

Hapi 2
Diskutohen fjalët e reja. Shpjegimi i tyre bëhet në mënyrë sa më të thjeshtë.

Hapi 3
Mësohet koncepti i krahasimit dhe me të edhe i hiperbolës. Ofrohen dhe lexohen shembuj krahasimi, duke vazhduar me detyrën që u kërkon nxënësve/nxënëseve të ofrojnë vetë shembuj të tillë krahasimi.

Hapi 4
Ofrohen shembuj ilustrues të stripave lidhur me krahasimin. Nxënësit/nxënëset i lexojnë dhe i diskutojnë.

Hapi 5
Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë shembuj krahasimi e hiperbole. Mund të jetë edhe detyrë shtëpie.

Hapi 6
Pjesa ABC – përgjigjja e saktë nën b – si shembull hiperbole.

Shënime:

_____

_____